

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7893
E premte, 27 shtator 2024
Çmimi 0.50 €

Policia e Kosovës thotë se vazhdon të trajnohet edhe nga ShBA-ja | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com


facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

26 VJET NGA MASAKRA E ABRISË, NJË NGA KRIMET MË MIZORE TË GJENOCIDIT TË SERBISË | FAQE 4-5



Wade Goddard (Courtesy Photo)



26 vjet më parë regjimi gjenocidal i Millosheviqit kreu masakrën brutale ndaj 23 anëtarëve të familjes Deliu, nga fëmija 2 vjeç, të rinj, gra e

deri te plaku 94 vjeç. Presidentja Osmani, kryeministri Kurti dhe liderët e opozitës, Krasniqi dhe Haradinaj, kanë përkujtuar

këtë masakër, duke theksuar se është një nga krimet më mizore të gjenocidit të Serbisë në Kosovë që ende askush nuk është dënua

OPINION

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E OKB-SË DHE ROLI I ALEKSANDËR VUÇIOTIT NË MARRËDHËNIET E RUSISË ME BALLKANIN PERËNDIMOR F.7

Shkruan:
Prof. dr. Fejzulla
BERISHA



AKTUALE



KOZ-ja E KOSOVËS DHE AJO E SHQIPËRISË ORGANIZOJNË PUNËTORINË E PËRBASHKËT PËR SHKËMBIM TË PËRVOJAVE F.2

MINISTRI DANEZ VJEN NË KOSOVË, DISKUTOHET PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES PËR BURGUN NË GJILAN. REAGON KMDLNJ F.5

EKONOMI

MBLIDHEN MINISTRAT E EKONOMISË TË BALLKANIT PERËNDIMOR, BISEDONJË PËR INTEGRIMIN EKONOMIK RAJONAL F.8

KOSOVA ADERON NË KONVENTËN E STAMBOLLIT NË ORGANIZATËN BOTËRORE TË DOGANAVE F.8

SPORT



PROMOVHET LIBRI I AZEM BROVINËS 'LIGA E KOSOVËS 1945-1990' F.10

KOMANDANTI I KFOR-IT: VAZHDIMI I DIALOGUT KOSOVË - SERBI KËRKON KURAJË DHE ANGAZHIM TË PALËVE F.3



SHQIPËRIA FTOHET TA HAPË KAPITULLIN E PARË NË BISEDIMET PËR ANËTARËSIM NË BE F.3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

KQZ-ja e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë organizojnë punëtorinë e përbashkët për shkëmbim të përvojave

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Komisionari Shtetëror i Zgjedhjeve në Shqipëri, Ilirjan Celibashi, së bashku me stafin e këtij institucioni, kanë vizituar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në Prishtinë. Kjo vizitë i parapriu fillimit të punëtorisë së përbashkët ndërmjet të dy institucioneve në qendër të së cilës është forcimi i bashkëpunimit mes dy institucioneve dhe shkëmbimi i përvojave në lidhje me informim dhe edukimin e votuesve, votimin jashtë vendit, përdorimin e teknologjisë informative në zgjedhje dhe raportimin digjital të financave të partive politike. Në fillim të kësaj punëtorie, kryesuesi i KQZ-së së Kosovës,



Kreshnik Radoniqi, vuri theksin në bashkëpunimin e mirë mes dy institucioneve, i cili në shumë raste është treguar edhe me ndihmën konkrete dhe

mbështetjen logjistike. Me këtë rast, Radoniqi kujtoi huazimin e kamerave për nevoja të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve gjatë Zgjedhjeve Lokale të vitit

2021 dhe gjatë procesit të votimit më 21 prill 2024. Gjithashtu, kryesuesi Radoniqi njoftoi edhe lidhur me ecurinë e organizimit të Zgjedhjeve për

Kuvendin e Kosovës, të cilat do të mbahen më 9 shkurt 2025.

Ndërkaq komisionari shtetëror i Shqipërisë, Ilirjan Celibashi, theksoi se bashkëpunimi mes dy institucioneve është forcuar dhe ka dhënë rezultate të prekshme për të dyja palët. Ai ka thënë se dy KQZ-të kanë përvoja sa të ngjashme aq dhe të ndryshme në proceset zgjedhore, ndaj shkëmbimi i këtyre përvojave do të ndihmojë në identifikimin e sfidave dhe marrjen e masave për mirorganizimin e proceseve zgjedhore.

Komisionari Celibashi solli në vëmendje votimin nga jashtë të shtetasve të Kosovës, përvojë e cila do t'i shërbejë KQZ-së së Shqipërisë për përgatitjen e procesit të votimit nga jashtë të shtetasve shqiptarë në vitin 2025.

Izraeli refuzon thirrjet e ShBA-së për armëpushim me Hezbollahun

JERUSALEM, 26 SHTATOR - Izraeli ka refuzuar propozimet për armëpushim me Hezbollahun - grupin libanez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara nga aleatët, përfshirë nga Uashingtoni, të cilët kanë kërkuar ndalim të luftimeve për tri javë, në mënyrë që të mundohet të gjendet një zgjidhje diplomatike për ta shmangur zgjerimin e luftës. "Nuk do të ketë armëpushim në veri", shkroi në X ministri i Jashtëm i Izraelit, Israel Katz. "Ne do të vazhdojmë luftën kundër organizatës terroriste Hezbollah me gjithë fuqinë tonë deri në fitore dhe kthimin e sigurt të banorëve veriorë në shtëpitë e

tyre". Këto deklarata shuajnë shpresat për një zgjidhje të shpejtë, pasi kryeministri i Libanit, Najib Mikati, shprehu optimizëm se një armëpushim mund të arrihet shpejt në Liban, ku qindra mijëra njerëz janë larguar nga shtëpitë e tyre për shkak të dhunës. Liderët botërorë kanë shprehur shqetësim se konflikti së bashku me luftën e Izraelit në Gazë kundër grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian, Hamas - mund të përshkallëzohet shpejt. Luftimet më të ashpra në pothuajse dy dekada mes Izraelit dhe Hezbollahut, që mbështetet

nga Irani, kanë rritur frikën se Izraeli mund të kryejë një ofensivë tokësore në Liban. ShBA-ja, Franca dhe disa aleatë të tjerë kanë bërë thirrje për një armëpushim 21-ditor përgjatë kufirit Izrael-Liban. Ata po ashtu mbështetën një armëpushim në Gazë. Izraeli ka nisur sulmet më të ashpra ajrore kundër Libanit që nga lufta e vitit 2006 dhe që nga java e kaluar janë vrarë më shumë se 600 persona. Hezbollahu po ashtu ka gjuajtur qindra raketa në Izrael dhe për herë të parë ka gjuajtur një raketë në Tel Aviv, edhe pse Izraeli tha se raketa shkaktoi dëme të vogla. Një ditë më herët, shefi i ushtrisë



izraelite përmendi mundësinë e një ofensive tokësore në Liban, teksa iu tha trupave izraelite që të bëhen gati. Tensionet mes Izraelit dhe

Hezbollahut janë të larta që 11 muaj, që kur ka nisur lufta në Gazë. Që atëherë, palët kanë këmbyer zjarr në kufi pothuajse në baza ditore.

Trumpi: Zelensky po merr miliardat, por po refuzon arritjen e ujdisë për përfundimin e luftës



WASHINGTON, 26 SHTATOR - Kandidati republikan për president amerikan, Donald Trump, e ka akuzuar presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky se po merr miliarda dollarë nga Shtetet e Bashkuara dhe, njëkohësisht, nuk po pranon ta "bëjë një marrëveshje" për t'i dhënë fund pushtimit të Ukrainës nga Rusia. Trump, i cili e ka kritikuar ashpër Uashingtonin për furnizimin e Kievit me ndihma, tha se Ukraina është dashur të bënte lëshime para presidentit të Rusisë, Vladimir Putin, në muajt para se Rusia ta niste pushtimin e plotë të saj në shkurt të vitit

2022. "Çfarëdo marrëveshje, qoftë më e keqja do të kishte qenë më e mirë se çfarë kemi tani", tha Trumpi. "Nëse ata do të bënin marrëveshje të keqe, prapëseprapë do të kishte qenë më mirë se tani. Ata do të kishin hequr dorë nga pak gjëra dhe të gjithë do të jetonin, dhe çdo ndërtesë do të ishte e ndërtuar, dhe çdo kullë do të jetonte edhe 2.000 vjet", tha Trumpi. Trumpi i bëri këto komente gjatë një tubimi zgjedhor në Karolinën Veriore, ndërkohë që Zelensky po merrte pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, para vizitës në Uashington më 26

shtator, ku presidenti Joe Biden pritet të njoftojë për ndihmë të re për Ukrainën. Trump shpesh ka pretenduar se Rusia nuk do ta kishte pushtuar Ukrainën, nëse ai do të kishte qenë president i ShBA-së dhe se ai do t'i jepte fund luftës shpejt, nëse do të kthehej në Shtëpinë e Bardhë. Megjithatë, ai nuk ka dhënë asnjë shpjegim të qartë se si do ta arrinte këtë. Në një debat më herët këtë muaj me kandidaten demokrate, nënpresidenten Kamala Harris, Trumpi refuzoi të thoshte nëse dëshironte që Ukraina ta fitonte luftën.

Komandanti i KFOR-it: Vazhdimi i dialogut Kosovë - Serbi kërkon kurajë dhe angazhim të palëve

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Komandanti i misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, Ozkan Ulutash, tha se vazhdimi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë mbetet thelbësor, por tha se kërkon kurajë dhe angazhim të sinqertë nga të dyja palët. Sipas tij, kjo është e mundur që të arrihet. "Ky dialog nuk është thjesht një domosdoshmëri politike, por edhe një imperativ moral për hir të brezave të ardhshëm", tha Ulutash. Gjatë një adresimi në Bruksel, në selinë e NATO-s, në përmblyllje të mandatit të tij në krye të KFOR-it, Ulutash tha se procesi i dialogut po vazhdon të përballet me pengesa. "Fatkeqësisht, ka ende shumë sfida. Ende ka tensione dhe mosbesim mes komuniteteve që po pengojnë përparimin. Dialogu politik në mes të Kosovës dhe Serbisë vazhdon të përballet me pengesa. Në këtë drejtim, NATO dhe KFOR-i mbështetnin plotësisht dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian si kornizë për një zgjidhje afatgjatë për çështjet e

pazgjidhura. Mbes optimist se me durim, përkushtim dhe qasje konstruktive nga të dyja palët, këto pengesa mund të tejkalohen", tha ai, sipas një njoftimi për medie. Duke folur për situatën e sigurisë, Ulutash tha se KFOR-i ka punuar me të gjitha komunitetet për t'iu ofruar mjedis të sigurt. Ai tha se gjatë udhëheqjes së KFOR-it ka mbikëqyrur koordinimin në një sërë fushash me BE-në, OSBE-në, OKB-në, institucionet e Kosovës dhe me komandantin e Forcave të Armatosura të Serbisë. "Ky bashkëpunim mbetet kritik për të mirën e sigurisë në mbarë Kosovën dhe për stabilitetin e rajonit", tha ai. KFOR-i është reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës që është e para dhe pas misionit të BE-së për sundim të ligjit, EULEX. Misioni i NATO-s në Kosovë, po ashtu, është përgjegjës për sigurinë e kufijve të Kosovës me Serbinë, ndërsa pjesën tjetër të vijës kufitare e mbikëqyr Policia e Kosovës.



Kuvendi dështon sërish ta miratojë Projektligjin për shëndetin riprodhues

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Kuvendi i Kosovës ka dështuar ta kalojë Projektligjin për shëndetin riprodhues (IVF), i cili ua mundëson grave të kenë qasje në IVF pa marrë parasysh se a janë beqare, në një çift homoseksual apo heteroseksual - në lexim të dytë gjatë një seance të enjten. Kjo është hera e gjashtë që deputetët dështojnë ta kalojnë këtë projektligj, i cili është zvarritur prej fillimit të këtij viti për shkak të disa ndryshimeve që ka kërkuar deputeti i partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), Visar Korenica. Korenica ka propozuar ndryshime, duke kërkuar që prej legjislacionit të largohen tre paragrafë të cilët parashohin se e drejta për riprodhim u takon edhe individëve, përveç çifteve të martuara (burrit dhe gruas). Si



referencë për individë, ai i ka përmendur gratë e pamartuara dhe partnerët e gjinisë së njëjtë. Të enjten Kuvendi nuk kishte kuorum të mjaftueshëm për ta votuar amendamentin e tij. Adelina Berisha nga Rrjeti i Grave të Kosovës tha në fillim të këtij muaji për Radion Evropa e Lirë se

nuk do të duhej që fati i askujt të varej nga bindjet personale të ndonjë individi që ka pushtet të marrë vendime për jetën e të tjerëve. "Do të duhej të bëhej një analizë se kush janë këta deputetë dhe cilat janë interesat e tyre, nëse janë kaq të vendosur atëherë do ta ndalonin si procedurë edhe nëpër

klinikat private, mirëpo në një anë duket sikur ka një interes që disa biznese të mbrohen", thotë Berisha. Korenica, gjithashtu, kërkon që në projektligj të mos jetë individi ai që vendos të ketë fëmijë, por të jetë vendim i çiftit. "Vetëm çiftet bashkëshortore kanë të drejtë për të vendosur me vullnetin e tyre për të pasur fëmijë dhe assesi individi, apo gruaja e pamartuar duke ia mohuar të drejtën fëmijës të ketë baba edhe nënë", kishte thënë Korenica gjatë një seance më herët këtë vit. Kjo është hera e gjashtë që ky legjislacion dështon të kalojë në Kuvend. Në tetor të vitit të kaluar, pas shumë përpjekjesh, Kuvendi kishte arritur që me 63 vota për, një kundër dhe katër abstenime ta miratonte në lexim të parë këtë

projektligj. Ky legjislacion ua mundëson edhe grave të pamartuara të mund të lindin fëmijë përmes metodës të fertilizimit të asistuar, i njohur si IVF, në klinikat publike. Ky ligj ishte kundërshtuar ashpër nga një pjesë e deputetëve. Sipas projektligjit, të drejtën e shfrytëzimit të IVF-së e kanë edhe gratë e pamartuara, mbi moshën 18-vjeçare, që janë në gjendje të mirë shëndetësore e sociale dhe janë të afta "për fertilizim dhe për përkujdesje prindërore". Kosova ka një repart të posaçëm për IVF-në në Klinikën e Gjinekologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Por, ai nuk është funksional pasi nuk ka pajisjet e nevojshme. Për pajisjet e këtij reparti, Ministria e Shëndetësisë ka ndarë 1.5 milion euro.

Shqipëria ftohet ta hapë kapitullin e parë në bisedimet për anëtarësim në BE

TIRANË, 26 SHTATOR - Vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE) janë pajtuar njëzëri për ta hapur kapitullin e parë në negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë më 15 tetor. Hungaria, e cila mban presidencën gjashtëmujore të BE-së, u ka dërguar një letër vendeve anëtare të bllokut, në të cilën theksohet se ato janë pajtuar se Shqipëria i ka përmbushur kushtet e nevojshme për hapjen e këtij kapitulli, i cili ka të bëjë me të drejtat themelore. Sipas metodologjisë së re të procesit të zgjerimit të BE-së, kapitujt që kanë të bëjnë me të drejtat themelore dhe sundimin e ligjit duhet të hapen në fillim, pasi në procesin e negociatave duhet të ketë më shumë kohë për t'i

përmbushur kriteret dhe për t'i mbyllur kapitujt. Ky është kapitulli i parë nga 33 në përgjithësi që Shqipëria duhet t'i hapë dhe mbyllë për t'u anëtarësuar në BE. Presidenca hungareze e BE-së ka thirrur të ashtuquajturën Konferencën Ndërqeveritare mes BE-së dhe Shqipërisë për 15 tetor, ku edhe do të hapet ky kapitull. Vendimi për hapjen e kapitullit të parë në negociatat me Shqipërinë shënon edhe ndarjen e paketës në të cilën joformalisht ishin së bashku Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Për disa vjet me radhë njëri nga këto shtete është mbajtur peng edhe nëse i kishte përmbushur kushtet duke pritur vendin tjetër t'i




plotësonte kushtet. Por, tani Shqipëria do të vazhdojë drejt BE-së ndaras nga Maqedonia e Veriut, rruga e së cilës vazhdon të jetë e bllokuar. Formalisht procesi i zgjerimit është një proces i bazuar në meritat

individuale të vendeve candidate për përmbushjen e kushteve, por nga aspekti politik, nganjëherë, në BE duan që më shumë vende të avancojnë në të njëjtën kohë. Vendet anëtare në BE nuk kanë arritur pajtim për hapjen e

kapitujve të parë me Maqedoninë e Veriut, pasi qeveria e re e këtij vendi nuk ka lëvizur drejt përmbushjes së kushtit lidhur me marrëdhëniet e saj me Bullgarinë, një vend anëtar i bllokut, i cili ka disa çështje të hapura me Maqedoninë e Veriut. Maqedonia e Veriut duhet ta ndryshojë Kushtetutën e vet për ta futur në të pakicën bullgare si popull shtetformues. Pasi së shpejti në Bullgari pritet të zhvillohen zgjedhjet e jashtëzakonshme, diplomatët në BE janë të mendimit se nuk ka shumë mundësi që Bullgaria të heqë dorë nga kundërshtimi i saj. Në BE thonë se Shqipëria tani ka gjasa të mëdha të lëvizë përpara dhe në dhjetor mund të hapë edhe disa kapituj.



Wade Goddard (Courtesy Photo)



26 vjet nga masakra e Abrisë, një nga krimet më mizore të gjenocidit të Serbisë

26 vjet më parë regjimi gjenocidal i Millosheviqit kreu masakrën brutale ndaj 23 anëtarëve të familjes Deliu, nga fëmija 2 vjeç, të rinj, gra e deri te plaku 94 vjeç. Presidentja Osmani, kryeministri Kurti dhe liderët e opozitës, Krasniqi dhe Haradinaj, kanë përkujtuar këtë masakër, duke theksuar se është një nga krimet më mizore të gjenocidit të Serbisë në Kosovë që ende askush nuk është dënuar

EPOKA E RE **Lirim GEÇI**

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Me rastin e 26-vjetorit të masakrës së familjes Deliu dhe tre dëshmorëve të fshatit Abri e Epërme të Drenasit, kryetari Ramiz Lladrovci ka bërë homazhe pranë Memorialit kushtuar familjes Deliu, ku prehen 23 anëtarë të kësaj familjeje martire. Homazhe ka bërë edhe kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, bashkë me kryetarin e komunës së Mitrovicës së Jugut, Bedri Hamza, deputetë të Kuvendit të Kosovës, familjarë dhe qytetarë të tjerë. "Me respektin më të lartë sot përkujtojmë të vrarët e masakrës së Abrisë së Epërme të Drenasit në 26-vjetorin e tmerrit serb mbi shqiptarët e pafajshëm dhe të pambrojtur. Lavdi për jetë e mot jetëve të humbura në

masakrën e Abrisë së Epërme! I përjetshëm qoftë kujtimi Diturijen e vogël!", ka thënë kryetari Nura. Masakrën e Abrisë e ka kujtuar edhe presidentja Vjosa Osmani. Ajo ka thënë se 26 vjet më parë regjimi gjenocidal i Millosheviqit kreu masakrën brutale ndaj 23 anëtarëve të familjes Deliu, nga fëmija 2 vjeç, të rinj, gra e deri te plaku 94 vjeç. "Jetët e tyre u morën mizorisht, por kujtimi për ta është i përherëshëm. Nuk do të harrojmë kurrë. Jemi të përkushtuar për ta ruajtur kujtesën për ta, sikurse edhe për të vendosur drejtësi. Sot nderojmë edhe sakrificën heroike të dëshmorëve të UÇK-së Valdet Xhemajli, Vesel Demaku dhe Afrim Hajdari, të cilët ranë në altarin e lirisë, duke mbrojtur dinjitetin dhe të ardhmen e Kosovës. Qoftë i përjetshëm kujtimi për martirët dhe dëshmorët e Abrisë!", ka

theksuar Osmani në deklaratën për medie. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se masakra e Abrisë është një nga krimet më mizore të gjenocidit të Serbisë në Kosovë. "Për të askush nuk është dënuar", ka thënë Kurti, duke shtuar se atë ditë i masakruan 23 anëtarë të familjes Deliu. "Më i moshuari ishte Fazli Deliu 94 vjeç. Më i ri u privua nga jeta që në barkun e nënës. Luljetës shtatzënë ia prenë barkun me foshnjën e palindur. E vranë edhe Mihanen, në krah me të birin, Mirin. Mihane Gashani Deliu, më 25 shtator kishte pasur ditëlindjen e 28. Valmir Deliu, më 21 shtator, kishte pasur ditëlindjen e dytë. Diturije Deliu, foshnja që ishte gjetur e gjallë në kraharorin me gjak të nënës, nuk mbijetoi. Ajo vdiq më 19 nëntor 1998, rrugës për në fshatin Tërdec, derisa po dërgohej te një mjek i luftës. I kishte vetëm 95 ditë jetë. Më 26 shtator 1998 forcat e armatosura serbe hynë edhe në fshatin Gollubovc të Malishevës. Aty i vranë 13 burra shqiptarë, civilë të paarmatosur. Pas torturave disaorëshe, ata i shtrinë përtokë, me duar pas koke. U ekzekutuan nga policia, një nga një, me nga dy plumba. Për këto krime askush nuk është dënuar. Në përvjetorin e 26 përkujtojmë 23 martirët e

masakrës në Abri të Epërme dhe 13 martirët e vrarë në Gollubovc. Përkujtojmë Valdet Xhemajlin, Vesel Demakun e Afrim Hajdarajn, që ranë dëshmorë atë ditë, duke mbrojtur popullatën civile. Nuk i harrojmë të rënë në rrugën e vështurë deri te çlirimi. Nderojmë kujtimin për ta duke u angazhuar për forcimin e Republikës sonë", ka thënë Kurti. Masakrën e Abrisë e ka kujtuar edhe lideri i PDK-së, Memli Krasniqi. "Më 26 shkurt të vitit 1998 Dituria ishte gjashtëjavëshe. Valmiri ishte dy vjeç. Luljeta ishte shtatzënë, duke pritur një Malësor ose Malësore që të vinte në jetë. Fazliu ishte 94 vjeç. Dituria nuk mbijetoi që të festonte ditëlindjen e parë. Valmiri nuk u regjistrua kurrë në shkollë. Malësori ose Malësorja nuk erdhën asnjëherë në jetë. Fazliu nuk vdiq në shtrat i rrethuar nga më të dashurit e tij. Jetët e këtyre të katërve, përsëri 19 anëtarëve tjerë të familjes Deliu, u prenë tragjikisht në mëngjesin e 26 shkurtit në Abri të Epërme nga forcat kriminale serbe. Kjo është historia e Kosovës. Kjo është vërteta e Serbisë. Kjo është dhembja me të cilën janë detyruar të jetojnë familja Deliu dhe të afërmit e tyre. Një krim që tejkalon gjithçka që fjalët mund të përshkruajnë", ka thënë Krasniqi,

duke shtuar se një tragjedi që nuk mori kurrë dënimin e merituar. Një padrejtësi e përjetshme, për të cilin nuk guxojmë të ndalemi asnjëherë së kërkuari drejtësi", ka thënë Krasniqi. Ai ka kujtuar edhe heronjtë e UÇK-së nga Abria e Epërme, që ranë po atë ditë në altarin e lirisë, Vesel Demaku, Valdet Xhemajli dhe Afrim Hajdaraj. Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka shkruar për masakrën e Abrisë. "26 vjet më parë, forcat serbe kryen një akt barbar ndaj familjes Deliu, duke mos kursyer askënd - nga foshnja disamuajshe deri te plaku 94 vjeçar. Ata ishin shqiptarë të pafajshëm që dëshironin vetëm të jetonin të lirë në trojet e tyre. Po atë ditë, mësuesi trim Vesel Demaku, së bashku me dy nxënësit e tij, Valdet Xhemajli dhe Afrim Hajdari, ranë duke luftuar me guxim kundër armikut, duke mbrojtur lirinë deri në frymën e fundit", ka thënë Haradinaj. Ai ka shtuar se Kosova e pagoi shtrenjtë okupimin me spastrim etnik, shkatërrime dhe humbje njerëzore. "Por vullneti ynë për liri dhe pavarësi mbeti i palëkundur, siç u përcaktuam edhe në referendumin historik të fundshtatorit të vitit 1991", ka thënë Haradinaj.



Policia e Kosovës thotë se vazhdon të trajnohet edhe nga ShBA-ja

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Policia e Kosovës tha se pjesëtarët e saj vazhdojnë të trajnohen nga partnerët e ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë, përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara. Reagimi i saj erdhi pas raportimeve nga disa medie në Kosovë se ShBA-ja i ka ndërprerë për një kohë trajnimet e Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës si "formë e sanksionimit" pas mbylljes së disa komunave paralele serbe në veri të vendit. "Radio Evropa e Lirë" kërkoi

konfirmim nga Ambasada Amerikane në Prishtinë dhe Departamenti Amerikan i Shtetit, por nuk mori përgjigje. Ngjashëm, kërkesës për koment nuk iu përgjigjën as në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës. "Me kërkesë të ShBA-së për pjesëmarrje në trajnime në ShBA, Policia e Kosovës në vazhdimësi, por edhe këtë javë ka nominuar zyrtarët e saj për pjesëmarrje në trajnime në ShBA", thuhet në njoftimin e policisë.

Aty, po ashtu, theksohet se Policia e Kosovës i merr "me shumë seriozitet" deklaratimet e Ambasadës Amerikane në Prishtinë që ndërlidhen me fushën e sigurisë dhe institucionin e policisë dhe se "është e gatshme të procedojë gjithçka që është e nevojshme" për ta ruajtur partneritetin me ShBA-në. Në një deklaratë për medie, të lëshuar më 30 gusht, Ambasada Amerikane tha se Qeveria e Kosovës "instrumentalizon"

policinë për të kryer veprime të pakoordinuara. Reagimi i saj erdhi në ditën kur autoritetet e Kosovës mbyllën disa institucione në veri të vendit - zonë e banuar me shumicë serbe - me arsyetimin se funksiononin jashtëligjshëm. Mbyllja e tyre shkaktoi reagime të ashpra nga bashkësia ndërkombëtare, e cila kërkon nga Kosova që çështjet që lidhen me situatën në veri, t'i trajtojë në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve

me Serbinë, i cili ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. I pyetur për pretendimet e Ambasadës Amerikane, ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla, tha në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" këtë javë se "Policia e Kosovës, si çdo polici tjetër në vendet demokratike, ka autorizime për veprimet e saj dhe ka edhe mbikëqyrje". "Askund më i fortë dhe më vigjilent se në veri të Kosovës nuk është Inspektorati Policor i Kosovës", tha Sveçla.



Ministri danez vjen në Kosovë, diskutohet për zbatimin e marrëveshjes për burgun në Gjilan. Reagon KMDLNj

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka zhvilluar një takim të rëndësishëm me homologun e saj, ministrin danez Peter Hummelgaard, ku diskutuan për përparimin e zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit për burgun e Kosovës në Gjilan, pas ratifikimit të traktatit mes dy vendeve.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje janë transferuar 5 milionë euro për renovimin e burgut dhe ndërtimin e infrastrukturës së ndërtimit nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, i cili tashmë ka nënshkruar kontratën për hartimin e specifikave teknike. Gjatë kësaj periudhe, përveç punimeve infrastrukturore, do të

trajnohet stafi aktual dhe do të rekrutohet stafi i ri, sipas nevojave të përcaktuara në marrëveshje.

Të dy ministrat theksuan rëndësinë e Komitetit të Përbashkët Drejtues, i cili do ta mbikëqyrë zbatimin e plotë të marrëveshjes, duke siguruar përmbushjen e standardeve për menaxhimin e burgut dhe përkujdesjen ndaj të burgosurve. Marrëveshja Bashkëpunuese ndërmjet dy vendeve do të finalizohet pas përfundimit të punëve teknike dhe do të rishikohet dy herë në vit. Të dy ministrat shprehën mirënjohje për njëri-tjetrin dhe ndaj ekipeve punuese, si dhe theksuan rëndësinë e implementimit të punëve sipas afateve të përcaktuara. KMDLNj ka reaguar ndaj këtij takimi, duke theksuar se ministri danez i Drejtësisë po viziton Kosovën për ta shënuar fillimin e rindërtimit të burgut në Pasjak të Gjilanit, ku dhunshëm dhe



kundër vullnetit të tyre do të vendosen të dënuarit me dëbim nga Danimarka, të gjithë nga vendet e treta dhe asnjëri danez apo shtetas danez. "Ministri danez deklaroi se me këtë marrëveshje shkarkohen burgjet e Danimarkës dhe se kjo qenka arsyeja e marrëveshjes së nënshkruar midis Hans Hakerup, ish ministrit racist danez të Drejtësisë dhe Albulena Haxhiut, shkelëses flagrante të drejtave të njeriut të personave të privuar nga

liria në Kosovë për faktin se ka legalizuar trajtimin diskriminues dhe degradues me të cilin të dënuarit nga Danimarka trajtohen si në hotele kurse të dënuarit kosovarë luftojnë për mbijetesë. Ministria e Drejtësisë e Kosovës po ia mbanë zhagun ministrisë raciste të Danimarkës e që nuk dallon asgjë nga ata", thuhet në reagimin e KMDLNj-së. KMDLNj ka treguar se ka bashkëpunuar me partnerët nga Danimarka për ta kundërshtuar

këtë marrëveshje dhe nga ta është informuar se profili i të dëbuarve u takon kriminelëve të rrezikshëm, të papërmirësueshëm dhe recidivistë. "Në mesin e tyre ka edhe ekstremistë fetarë. KMDLNj ka kundërshtuar dhe e kundërshton këtë marrëveshje që rëndë shkelë të drejtat e të burgosurve kosovarë dhe do të thërrasë publikisht familjarët e të burgosurve kosovarë të kundërshtojnë zhvendosjen e tyre në burgjet tjera kundër vullnetit të tyre. KMDLNj do të përkrahë të drejtat e të burgosurve kosovarë që ato të drejta të janë të njëjta me të drejtat e të burgosurve të dëbuar dhunshëm nga Danimarka e që do të vendosen dhunshëm në burgun e Pasjakut të Gjilanit. Për KMDLNj vizita e ministrit danez të Drejtësisë është në funksion të legalizimit të dy sistemeve korrektuese brenda një shteti prandaj nuk është i mirëseardhur", ka theksuar KMDLNj.

Komuna e Rahovecit mbetet e përkushtuar për përmirësimin e kushteve dhe të qasjes në shërbime



RAHOVEC, 26 SHTATOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, së bashku me bashkëpunëtorë, me zyrtarë komunalë, të policisë, të QKMF-së, me zyrtarë të QPS-së, të Njësisë për të Drejtat e Njeriut, të sektorit për Barazi Gjinore, të sektorit për

Integrime Evropiane, të OSBE-së dhe me përfaqësues të shoqërisë civile e të komuniteteve joshumicë, mori pjesë në tryezën e organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, ku diskutuan çështjen e respektimit të të drejtave të

njeriut, përfshirë ato të komuniteteve joshumicë, si dhe shkëmbyen përvoja dhe praktika të mira. "Falënderoj z. Naim Qelaj për angazhimin e tij të palodhshëm dhe bashkëpunimin e frytshëm me komunën tonë. Komuna e Rahovecit mbetet e

përkushtuar për përmirësimin e kushteve dhe të qasjes në shërbime, për të krijuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse. Inkurajoj çdo qytetar të raportojë çdo rast të shkeljes për ta siguruar mbrojtjen e të drejtave të secilit!", ka thënë kryetari Latifi.

Haradinaj drejton sërish kritika për qeverinë Kurti

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka drejtuar sërish të enjten kritika për qeverinë Kurti. Ai ka thënë se kjo qeveri e anuloi projektin Amerikan të gazit, e detyroi kompaninë amerikane të tërhiqej nga Kosova C sepse iu duk çmimi prej 80 eurosh tepër i lartë. "U mbështetën tek mafia energjetike e rajonit që dihet se nga kush udhëhiqet dhe paguan veç për dy vjet (2022 dhe 2023), hiç më pak se 365,706,835.9 euro para të Kosovës. Në krahasim me dy vitet 2018 dhe 2019 kjo është afër 4.5 herë më shumë apo 282 euro

milione më shumë nga koha sa kemi importuar në kohën kur unë isha Kryeministër. Me të vërtetë tronditëse e dhëna se për dy vjet mesatarja e pagesës ditore për mafinë energjetike është hiç më pak se 500.000 euro në ditë. Këto janë të dhëna nga raporti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike të Kosovës, për vitin 2023", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Ai ka shtuar se: "Më shanë e më fyen sepse desha që Kosova C të prodhonte rrymë me çmim prej 83 euro. E morën pushtetin dhe blenë rrymë në vitin 2022 me çmim

mesatar prej 268.82 euro dhe në vitin 2023 prej 129 euro. I shërbyen jo shtetit të Kosovës dhe popullit të saj, por mafisë energjetike. Figurat kryesore të VV-së po i heton Prokuroria dhe do të hetojë dhe gjejë gjithçka, por një dihet; se ky është krim që i është bërë këtij vendi dhe askush nuk duhet të shkojë në përgjegjësi para Kryeministrit aktual të Kosovës. Krenohet nga foltorja e Parlamentit "se ka ç'montuar Contour Globalin", po del se ka dashtë ta ç'montojë popullin e vet", ka shkruar Haradinaj.



Sekuestrohen armë dhe substancë narkotike, arrestohen dy persona në Podujevë

PODUJEVË, 26 SHTATOR - Policia e rajonit të Prishtinës, në kuadër të punës së saj, ka shtuar veprimet në drejtim të identifikimit dhe kapjes së personave që kanë shtrirë aktivitetin e tyre kriminal në fushën e shitblerjes së substancave narkotike. Një nga kontrollet është ndërmarrë nga zyrtarët policorë të Podujevës mbrëmë në rrugën "Zahir Pajaziti" në Podujevë. Mbështetur mbi

bazën e dyshimit të arsyeshëm, në rrugën e sipërhënuar është kryer një kontroll ndaj një personi të dyshuar, të cilit i është gjetur dhe sekuestruar një armë dhe sasi e substancës narkotike, 48 qese rreth 100g. Pjesë e aksionit ka qenë kontrolli i vendbanimit të të dyshuarit dhe objekteve përcjellëse, në rrugën



"Fitorja" në Podujevë, ku janë gjetur dhe sekuestruar një pushkë gjuetie, dy pistoleta (TT, Bereta), pesë karikatorë, municion, para të gatshme rreth 1 000 euro, një mjet i prehtë-thikë dhe tre telefona. Lidhur me rastet janë errësuar dy persona të dyshuar. F. E., mashkull, shtetas i Republikës së Kosovës, është iniciuar hetim

në drejtim të veprës penale posedim i paautorizuar i substancave narkotike, psikotrope ose analoge. Me aktvendim mbi ndalimin e personit të dyshuar të nxjerrë nga ana e prokurorit të shtetit, i dyshuari është dërguar në qendrën e mbajtjes prej 48 orësh. Ndërsa ndaj të dyshuarit B. F., mashkull, shtetas i Republikës së Kosovës, është iniciuar rast për armëmbajtje pa leje.

Kuvendi i Komunës së Gjilanit dështon sërish të mbajë seancën

Gjilan, 26 shtator - Kuvendi i Komunës së Gjilanit ka dështuar sërish të mbajë seancën e rregullt, për shkak se opozita, e cila e ka shumicën në këtë përbërje, po e kushtëzon pjesëmarrjen e saj me transmetim të drejtpërdrejt medial, duke mos u mjaftuar me transmetim online përmes live stream dhe shpërndarjes së saj në shumicën e medieve lokale. Avdyll Aliu, shef i grupit të këshilltarëve të LDK-së, ka thënë se nuk janë krijuar kushte për transparencë minimale, prandaj ata nuk pranojnë të jenë pjesë e seancës derisa nuk përmbushet



kjo kërkesë e kahershme e opozitës. "Ne jemi të interesuar për punë, por jo në këto kushte të

terror informativ", ka thënë Aliu. Ndërkaq, Ismail Kurteshi nga LV-ja tha se kjo seancë sot i

përmbushë kushtet ligjore për t'u mbajtur dhe ka kërkuar nga grupi i këshilltarëve të LDK-së që të mos e braktisin Kuvendin. "Ata që e lëshojnë seancën marrin përgjegjësi para qytetarëve të komunës së Gjilanit", ka thënë Kurteshi, duke shtuar se ajo që po kërkohet nga shefi i grupit të këshilltarëve të LDK-së është e përtej ligjshme, megjithëse u pajtua që edhe kjo kërkesë të plotësohet. Pasi LDK-ja e braktisi sallën e mbledhjeve, Kuvendi mbeti pa kuorum, për çka kryesuesi Kushtrim Kadriu u detyrua të

ndërpres seancën. Përndryshe, në rend dite të seancës së sotme, të gjashtës me radhë, kanë qenë këto pika: Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Gjilanit për vitin 2023 (Plani i veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit), Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për Komunën e Gjilanit, Projekt Rregullorja për ndarjen e bursave, Diskutimi rreth ngritjes së kujdesit institucional për grupet e marginalizuara.

"Barna dhe trajtime mjekësore", komuna e Mitrovicës subvencionon rreth 1 000 qytetarë

MITROVICË, 26 SHTATOR - Drejtorja për Shëndetësi ka njoftuar se ka bërë ekzekutimin e mjeteve financiare nga Drejtorja për Buxhet dhe Financa për qytetarët e komunës së Mitrovicës, të cilët kanë parashtruar kërkesa për ndihmë financiare për përbalimin e shpenzimeve për barna dhe trajtime mjekësore. Gjatë muajit prill është bërë

pagesa për grupin e parë të kërkesave të parashtruara në Drejtorinë për Shëndetësi për 400 qytetarë në vlerë prej 43 000.00 eurosh, ndërsa gjatë ditës së djeshme është ekzekutuar kontingjenti i dytë për 599 qytetarë përfitues, në vlerë totale prej 57 800.00 eurosh. Drejtori Shabani ka deklaruar se edhe këtë vit komuna e Mitrovicës nga të hyrat vetjake ka subvencionuar për

mbulimin e shpenzimeve për barna dhe trajtime mjekësore gjithsej 999 qytetarë në vlerë totale prej 100 000.00 eurosh. Drejtorja për Shëndetësi, përveç ofrimit të shërbimeve shëndetësore të kujdesit parësor, furnizimit të mirë me barna esenciale, po arrin që edhe nga kategoria subvencione dhe transfere t'u dalë në ndihmë qytetarëve që kanë probleme shëndetësore përmes mjeteve financiare.



Asambleja e Përgjithshme e OKB-së dhe roli i Aleksandër Vuçiqit në marrëdhëniet e Rosisë me Ballkanin Perëndimor



Shkruan:
Prof. dr. Fejzulla BERISHA

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (OKB) përfaqëson një nga forumet më të rëndësishme të diplomacisë ndërkombëtare, ku shtetet anëtare diskutojnë çështje që prekin sigurinë ndërkombëtare, të drejtat e njeriut dhe zhvillimin ekonomik. Për vendet e Ballkanit Perëndimor kjo platformë ka rëndësi të veçantë, pasi këto shtete janë ende të përfshira në proceset e integritimit evropian dhe ndërtimit të institucioneve demokratike. Në këtë kontekst, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka zënë një vend të spikatur në diskursin diplomatik

ndërkombëtar. Vuçiqi, që nga ardhja e tij në pushtet në vitin 2014, është kritikuar për lidhjet e tij të ngushta me Federatën Ruse, megjithëse formalisht synon ta përshpejtojë integrimin e Serbisë në Bashkimin Evropian (BE). Marrëdhëniet e tij me Rusinë kanë ndikuar që ai të shihet si një ndërmjetës i interesave të Kremlinit në Ballkanin Perëndimor, çka e ka bërë një figurë të diskutuar në politikën ndërkombëtare.

Serbia ndërmjet Rosisë dhe Perëndimit. Politika e jashtme e Serbisë në udhëheqjen e Vuçiqit ka ndjekur një qasje të balancuar ndërmjet Rosisë dhe Perëndimit. Ndërkohë që Serbia ka aspirata për anëtarësim në BE dhe ka zhvilluar marrëdhënie të fuqishme me vendet anëtare të BE-së, ajo ka ruajtur një aleancë të fortë me Rusinë në disa fusha strategjike, përfshirë bashkëpunimin ushtarak dhe diplomatik. Këto marrëdhënie ndërtohen mbi baza historike dhe kulturore, duke pasur parasysh

aleancën e gjatë mes Serbisë dhe Rosisë si shtete ortodokse sllave. Mbështetja diplomatike e Rosisë ka qenë jetike për Serbinë, veçanërisht në çështjen e Kosovës, ku Moskë ka përdorur veton e saj në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për të penguar njohjen ndërkombëtare të Kosovës.

Vuçiq si Promotor i Interesave Ruse në Ballkan. Disa analistë ndërkombëtarë dhe zyrtarë e kanë përshkruar Vuçiqin si një përfaqësues të interesave ruse në Ballkanin Perëndimor, duke theksuar se ai ka ndihmuar në përfundimin e agjendës gjeopolitike të Kremlinit në rajon. Ky perceptim u intensifikua pas agresionit të Rosisë ndaj Ukrainës, kur Serbia, ndryshe nga shumica e vendeve evropiane, refuzoi të vendoste sanksione kundër Rosisë. Vuçiq ka mbrojtur këtë vendim si një masë për të mbrojtur interesat e brendshme të Serbisë, përfshirë ruajtjen e stabilitetit ekonomik dhe politik të vendit. Ndikimi i Rosisë në Ballkan mbetet një burim

shqetësimi për Bashkimin Evropian dhe NATO-n, të cilat përpiqen të zgjerojnë integrimin e rajonit dhe të zvogëlojnë ndikimin e Moskës.

Çështja e Kosovës dhe roli i Vuçiqit në OKB. Një nga çështjet më të ndjeshme që Vuçiq ka trajtuar në Asambelën e Përgjithshme të OKB-së është njohja e pavarësisë së Kosovës. Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, Serbia ka kundërshtuar njohjen e saj dhe ka ndërmarrë përpjekje diplomatike për të penguar integrimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. Rusia ka mbështetur fuqishëm Serbinë në këto përpjekje, duke përdorur ndikimin e saj në Këshillin e Sigurimit për të bllokuar çdo rezolutë që do të avanconte njohjen e Kosovës. Vuçiq ka përdorur forume diplomatike ndërkombëtare për të riafirmuar qëndrimet e Serbisë ndaj Kosovës, duke theksuar rëndësinë e dialogut, por duke refuzuar çdo kompromis që do të nënkuptonte njohjen e pavarësisë së saj.

Tolerimi i Perëndimit ndaj Vuçiqit dhe roli i tij i dyfishtë. Pavarësisht lidhjeve të dukshme me Moskën, Perëndimi ka adoptuar një qasje pragmatike ndaj Vuçiqit, për një sërë arsyes të ndërlukuara diplomatike dhe gjeopolitike. Disa prej këtyre faktorëve përfshijnë:

- Stabiliteti i rajonit: Perëndimi, veçanërisht BE dhe SHBA, e shohin Vuçiqin si një lider që ka arritur të ruajë stabilitetin brenda Serbisë dhe në marrëdhëniet e saj me fqinjët. Megjithë politikat e tij pro-ruse, Perëndimi preferon të merret me një figurë të qëndrueshme sesa të rrezikojë destabilizimin e rajonit.

- Dialogu për Kosovën: Vuçiq është një aktor kyç në dialogun ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, të ndërmjetësuar nga BE dhe mbështetur nga SHBA. Për Perëndimin, bashkëpunimi i tij është i domosdoshëm për çdo marrëveshje të ardhshme për normalizimin e marrëdhënieve.

- Politika e zgjerimit të BE-së: Serbia është një kandidat për anëtarësim në BE, dhe integrimi i saj gradual shihet si një mënyrë për të tërhequr Serbinë nga sfera e ndikimit rus. Kjo qasje, megjithëse e ngadaltë, ka për qëllim që në afat të gjatë të zvogëlojë ndikimin e Moskës në rajon.

- Ekonomia dhe investimet perëndimore: Ndërkohë që Vuçiq ka ruajtur lidhjet me Rusinë, ekonomia serbe është gjithnjë e më shumë e varur nga investimet dhe tregtia me vendet e BE-së. Kjo varësi ekonomike e bën të vështirë për Perëndimin të ndërmarrë masa të ashpra kundër Vuçiqit pa dëmtuar interesat e tij ekonomike në Serbi. Perëndimi, përmes kësaj qasjeje pragmatike, synon të ruajë një balancë delikate në Ballkanin Perëndimor, duke mbajtur Vuçiqin brenda kornizës diplomatike ndërkombëtare, ndërsa punon për ta larguar gradualisht nga orbita e ndikimit rus. Megjithatë, kjo strategji është e rrezikshme dhe kërkon një qasje të kujdesshme, pasi dështimi i saj mund të çojë në destabilizimin e mëtejshëm të rajonit dhe në përfundimin e lidhjeve të Serbisë me Kremlin (Moskën).



Kuvendi anulon logon që e miratoi javën e kaluar pas reagimeve, nis procedurën e re të përzgjedhjes

PRISHTINE, 26 SHTATOR - Kuvendi ka njoftuar se është anuluar logoja e përzgjedhur së fundi për Kuvendin e Kosovës pas kritikave për ngjashmëri me një logo të një kompanie planifikuese ekspozitash në Riad të Arabisë Saudite.

Në njoftimin për medie thuhet se në mbledhjen e kryesisë të mbajtur më 23 shtator është trajtuar kjo çështje dhe është konstatuar se logoja e Kuvendit nuk duhet të ketë ngjashmëri me ndonjë logo tjetër. Rregullorja e Kuvendit

parashihet që Kuvendi ta ketë logon e vet dhe se forma e saj miratohet nga Kryesia e Kuvendit. "Pas njoftimit që kemi pranuar se ka pasur reagime nga persona të fushës së dizajnit apo mediaticë, Kryesia e Kuvendit të Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 23.09.2024 e ka trajtuar çështjen e logos së Kuvendit dhe ka konstatuar se e njëjta nuk duhet të ketë ngjashmëri me ndonjë logo tjetër, pavarësisht se logoja e përzgjedhur nga Juria profesionale nuk ka qenë

identike me logon më të cilën është krahasuar. Ndërsa, pas një takimi ndërmjet përfaqësuesve të Kuvendit dhe operatorit ekonomik fitues, është konstatuar se logoja e përzgjedhur ka ngjashmëri me logon e krahasuar, pavarësisht se nuk janë identike. Të dy palët u pajtuan që Kuvendi i Kosovës duhet të ketë logo e cila nuk ka ngjashmëri me asnjë logo tjetër. OE zyrtarisht u pajtua t'i kthejë mjetet financiare të pranuar nga Kuvendi, si dhe ka kërkuar që të kthejë në pronësi të saj të



drejtën e autorit të logos së propozuar. Kuvendi i Kosovës do të zhvillojë procedurën e re

për përzgjedhjen e logos së Kuvendit", ka njoftuar Kuvendi.

Kurti në Nju-Jork flet për zbatimin e reformave të rëndësishme ekonomike

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Takimet në Nju-Jork të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kryeministri Albin Kurti i ka vazhduar me drejtoreshën menaxhuese të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Kristalina Georgieva, në ambientet e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës sonë atje. Në diskutim e sipër në lidhje me performancën ekonomike në vitet e fundit, kryeministri Kurti fillimisht e falënderoi Georgieva për mbështetjen e vazhdueshme të FMN-së ndaj Kosovës në ndërtimin e

kapaciteteve të qëndrueshme institucionale dhe zbatimin e reformave të rëndësishme ekonomike. Në takim u diskutua edhe rreth zbatimit të programeve që Kosova ka me FMN-në ku u veçua progresi i mirë i programit për Reziliencë dhe Qëndrueshmëri (Resilience and Sustainability Facility) përmes të cilit Kosovës i është mundësuar rritja e kapaciteteve të reja të energjisë së ripërtërishme, ndërkohë që u theksua përkushtimi për zbatimin e plotë edhe të programit të Aranzhimit për



Gatishmëri (Stand by Arrangement). Drejtoresha menaxhuese, Georgieva, e uroi Kosovën për rezultatet dhe suksesin e

arritur në qëndrueshmërinë fiskale, si dhe për zbatimin me sukses të programeve aktuale të IME Ajo theksoi që rezultatet e Kosovës në menaxhimin e

borxhit publik mund të shërbejnë si shembull edhe për ekonomitë e tjera. Gjatë bashkëbisedimit u diskutua edhe rreth mundësive të reja të bashkëpunimit në përmbushjen e agjendës së reformave ekonomike, realizimin e investimeve në infrastrukturë dhe energji, përmirësimin e klimës investive dhe avancimin e mjedisit për të bërë biznes. Në takim bashkë me kryeministrin ishte ministri i Financave, Punës dhe Trasnferëve, Hekuran Murati.

Mblidhen ministrat e ekonomisë të Ballkanit Perëndimor, bisedojnë për integrimin ekonomik rajonal

EPOKA E RE Qendresa RAMA

BERLIN, 26 SHTATOR - Ministrat e Ekonomisë u mbledhën në Berlin për ta shënuar dhjetëvjetorin e Procesit të Berlinit dhe për ta vendosur agjendën e ardhshme. Danijela Gacevic, drejtoreshë në detyrë e Sekretariatit të CEFTA-s, mori pjesë në Konferencën e organizuar nga ministri Federal i Çështjeve Ekonomike dhe Veprimit Klimatik, dr. Robert Habeck.

Konferenca, që mbledhi së bashku ministra, liderë të biznesit dhe ekspertë ndërkombëtarë, u përqendrua në vlerësimin e progresit drejt krijimit të Tregut të Përbashkët



Rajonal (CRM).

Mundësitë ekonomike të rajonit, teksa afrohet me integrimin në BE, ishin në qendër të diskutimeve, së bashku me dhjetë marrëveshje të rëndësishme të lehtësimin të tregtisë së CEFTA-s që janë në

pritje të miratimit. Gacevic theksoi rëndësinë e këtyre vendimeve për arritjen e lirisë së plotë të lëvizjes së mallrave dhe shërbimeve: "Miratimi i këtyre marrëveshjeve do të jetë një hap i rëndësishëm drejt një Tregu të Përbashkët

Rajonal në përputhje me BE-në. Secila prej tyre është një paketë përfitimesh për bizneset dhe konsumatorët që do të na afrojë jo vetëm me njëri-tjetrin, por edhe me BE-në. Prandaj, është thelbësore që t'i miratojmë sa më shpejt".

Marrëveshjet në kuadër të CEFTA-s miratohen nga Komiteti i Përbashkët në formën e Vendimeve, Protokolleve Shtesë ose Rekomandimeve. Aktualisht, dhjetë marrëveshje të tilla janë në pritje të miratimit në fusha të ndryshme: tregtia elektronike, shërbimet e shpërndarjes së pakove, parandalimi i bllokimit të pajustifikuar gjeografik, kualifikimet profesionale, pronësia intelektuale, menaxhimi

i rrezikut, shërbimet e agjencive të udhëtimit, sigurimi i motorëve, njohja e operatorëve ekonomikë të autorizuar dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve tregtare. Rezultatet e konferencës nënvizojnë rëndësinë në rritje të Ballkanit Perëndimor në peizazhin ekonomik evropian. Përparimi në CRM i hap rajonit derën drejt Tregut të Vetëm të BE-së, duke shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga Plani i Rritjes i BE-së. Para Konferencës, Forumi i Biznesit mbledhi së bashku kompani gjermane dhe nga Ballkani Perëndimor në një aktivitet B2B që synonte nxitjen e zinxhirëve të përbashkët të furnizimit dhe promovimin e mundësive të investimit në rajon.

Kosova aderon në Konventën e Stambollit në Organizatën Botërore të Doganave

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Republika e Kosovës ka aderuar në Konventën e Stambollit në Organizatën Botërore të Doganave me seli në Bruksel, duke u bërë shteti më i ri anëtar i kësaj Konvente. Ky është një hap historik për Kosovën, që shënon një arritje të rëndësishme në avancimin e procedurave doganore dhe lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare. Aderimi në Konventën e Stambollit për transportin ndërkombëtar të mallrave do t'i thjeshtojë dhe shpejtojë proceset doganore për mallrat, duke rritur efikasitetin dhe duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit. Dorëzimi zyrtar i instrumentit të

anëtarësimit në Konventën për Pranim të Përkohshëm u bë nga udhëheqësi i Misionit Diplomatik të Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Belgjikës, ambasadori Agron Bajrami dhe drejtori i përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, përderisa nënshkrimi i saj ishte bërë nga zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla. Me rastin e aderimit të vendit tonë në këtë Konventë të rëndësishme, sekretari i përgjithshëm i Organizatës Botërore të Doganave (OBD), Ian Saunders, e ka përgëzuar Kosovën për aderimin në Konventën e Stambollit dhe



përkushtimin e saj për zbatimin e procedurave doganore që promovojnë lehtësimin dhe sigurinë e tregtisë. E miratuar në vitin 1990, Konventa e Stambollit thjeshton

pranimin e përkohshëm të mallrave përtej kufijve, përderisa OBD luan rol kyç në mbikëqyrjen e zbatimit të konventës dhe ofrimin e udhëzimeve për vendet anëtare.

Që nga anëtarësimi i saj në OBD, Kosova ka përmbushur standardet ndërkombëtare duke aderuar në Konventën e tjerë të rëndësishme tregtare. Si anëtar i 81-të i Konventës së Stambollit, Kosova i bashkohet një numri në rritje të vendeve që përfitojnë nga procedurat doganore të thjeshtuara për importet e përkohshme. Ky anëtarësim do t'i përmirësojë përpjekjet e Kosovës për lehtësimin e tregtisë, do të tërheqë investime të huaja dhe do ta forcojë integrimin e saj në ekonominë globale, duke mbështetur kështu rritjen e qëndrueshme ekonomike.



Anëtarja e kryesisë së PDK-së mban ligjëratë mbi zhvillimin ekonomik dhe social në Universitetin e Pitsburgut

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Anëtarja e kryesisë së PDK-së, Besa Kabashi-Ramaj, ka mbajtur këtë vit ligjëratën Saul M. Katz mbi zhvillimin ekonomik dhe social në Universitetin e Pitsburgut. E organizuar nga University of Pittsburgh Graduate School for Public and International

Affairs, Instituti Ford për Sigurinë Njerëzore dhe Qendra Matthew B. Ridgway për Studimet Ndërkombëtare të Sigurisë, ky leksion prestigjioz thekson udhëheqjen dhe angazhimin e saj të vazhdueshëm ndaj shërbimit publik dhe sigurisë kombëtare. Kabashi-Ramaj ka ndarë

njohuritë e saj për rrugën e Kosovës drejt sigurisë si dhe vizionin e saj për Kosovën e mbrojtur, të sigurt dhe me një ardhme të begatë për gjeneratat e reja. Po ashtu, Kabashi-Ramaj ka zhvilluar takime me rëndësi me ekspertë të sigurisë dhe profesorë të kësaj fushe.





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Promovohet libri i Azem Brovinës 'Liga e Kosovës 1945-1990'

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Gazetari dhe komentatori i njohur Azem Brovina ka promovuar librin e tij të tretë për futbollin e Kosovës, të titulluar "Liga e Kosovës 1945-1990". Ceremonia e promovimit u mbajt sot në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës. Ky libër, i cili është botuar nga shtëpia botuese "Orfeu", u mbështet edhe nga FFK dhe përmban të gjitha rezultatet dhe tabelat e rëndësishme për historikun e futbollit të Kosovës në këtë periudhë.

Në këtë promovim morën pjesë emra të njohur të futbollit të Kosovës, drejtues të FFK-së dhe

gazetarë. Gjatë fjalimit të tij, autori Brovina theksoi rëndësinë e dokumentimit të saktë të historisë së futbollit të Kosovës, duke shtuar se ky libër është një kontribut i vlefshëm për të kuptuar më mirë sukseset dhe zhvillimet e këtij sporti në Kosovë. Ai vuri në dukje se vendet e Ballkanit, përfshirë Kosovën, kanë pasur një histori të lavdishme të futbollit pas Luftës së Dytë Botërore e deri në prishjen e ish-federatës.

Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, vlerësoi lart punën dhe trashëgiminë e Azem Brovinës, duke e cilësuar si një inspirim për



brezat e rinj. Ademi theksoi se Brovina me zërin e tij emblematic ka qenë një figurë kyçe e transmetimeve sportive dhe se libri i tij i fundit përfaqëson një burim të rëndësishëm të të dhënave historike për futbollin e Kosovës. Kjo vepër është e treta në radhë për Azem Brovinën, pas dy

librave të tij të mëparshëm për futbollin e Kosovës: "1282 transmetime dhe komentime në RTP & RTK: fakte, shpjegime, kujtime", si dhe monografinë "Futbolli i Kosovës 1919-2019".

Në librin "Liga e Kosovës 1945-1990" autori përshkruan fillimet e organizimit të futbollit në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore. Futbolli ka filluar të luhet në Kosovë që në vitet 1920, më vonë formohen shoqata të ndryshme sportive dhe ekipe të cilat përfaqësojnë qytete të ndryshme. Një prej personave të këtij libri është Faik Dushi, i cili solli topin e parë të futbollit në qytetin e

Gjakovës në vitin 1924, pasi ishte kthyer nga studimet në Francë. Ai kontribuoi edhe në formimin e ekipeve të para në Prishtinë dhe qytete të tjera të Kosovës.

Azem Brovina ka lindur më 16 nëntor 1946 në Gjakovë. Ka përfunduar studimet në Degën e Gjeografisë në Fakultetin Filozofik në vitin 1970. Ka punuar gazetar i sportit dhe komentator në Radio Prishtinë që nga gushti i vitit 1970, më pas në Radio Kosova deri në vitin 2013, duke transmetuar dhe komentuar 1 282 ndeshje. Gjithashtu, ka transmetuar 158 duele të ndryshme në RTK.

Gega: Sporti elitari do sakrifica

TI RANË, 26 SHTATOR - E pranishme në "Vlora Cross Country", event i organizuar nga Federata Shqiptare e Atletikës, Luiza Gega, është rikthyer të flasë për zhgënjimin e pësuar në Lojërat Olimpikë "Paris 2024", ku nuk mundi të kualifikohet për në finale. Në një intervistë për "Panorama Sport", ikona e atletikës shqiptare e cilëson si fazë reflektimi periudhën aktuale, ndërsa thekson se nuk ka ndër mend të tërhiqet, dhe është e gatshme të thyejë të tjera rekorde, teksa më të fundit e vendosi të dielën e kaluar në Maratonën e Prishtinës. Gega, gjithashtu, ka një mesazh edhe për të rinjtë, teksa i këshillon të punojnë fort, pasi vetëm me punë arrihen rezultatet.

Luiza, duke iu rikthyer edhe një herë Olimpiadës, si e përshkruani pjesëmarrjen në Paris?

Gega: Nëse do të flasim për mua si sportiste në Lojërat Olimpikë, paraqitja nuk ishte aty ku doja, por sporti është i tillë, jo gjithmonë do të jesh në formën maksimale. Kjo është e bukura e sportit që ka kaq

emocione, pasi kurrë nuk dihet ai fundi.

Çfarë ndodhi me ju në atë garë?

Gega: Unë në muajin prill kalova një virozë që më ndikoi jashtë mase në performancën time duke qenë se unë stërvitem për limitet, për të parë se ku i kam limitet dhe ndonjëherë kjo ndikon jashtë mase shumë. Mund të duket diçka e vogël, por ka të bëjë shumë për performancën e një sportisti. Po stërvitesha fort, qoftë edhe me virozë, sepse gara po afronte, koha po limitohej. Kjo bëri që të më binin edhe parametrat biologjikë. Një nga arsytet që pse edhe unë rri nëpër male është kjo që të rris sa më shumë rruazat e kuqe, hemoglobinën dhe quhet doping natyral për ne sportistët e distancave. Por viroza ma shkatërroi këtë pjesën dhe kjo bëri që të mos e merrja veten për atë nivel që unë kërkoja në Lojërat Olimpikë.

Ju mërzi kjo situatë?

Gega: Patjetër që u mërzi shumë,



në radhë të parë për lodhjen që kam bërë për vite me radhë. Nuk është puna vetëm për muajt finalë. Por sporti i ka këto, nuk kam çfarë të bëj.

Cilat janë objektivat tuaj në vazhdim?

Gega: Për mua kjo është periudhë

reflektimi. Ende nuk kam vendosur objektiva, sepse pata një zhgënjim personal për Lojërat Olimpikë, kështu që dua ta mendoj pak më gjatë, pasi të vendosësh objektiva duhet të jesh gati psikologjikisht. Duhet të jesh gati për sakrificat që kërkojnë objektivat, stërvitjen në male, larg familjes, larg jetës sociale. Kështu që sporti elitari ka shumë sakrificë.

E keni menduar tërheqjen?

Gega: Unë e kam shumë të vështirë tërheqjen, kur po thyej rekorde. Pak ditë më parë theva rekord në maratonë. Ndoshta mund ta shikoj veten në garat e rrugës në të ardhmen, por në një moment të dytë. Tani nuk mund ta them se çfarë kam vendosur për të ardhmen. Gjithsesi po e shijoj këtë pjesën se jam pak më e lirë dhe kam mundësi që të vij dhe të takoj fëmijë siç jam sot (dije) këtu në Vlorë. Jam shumë e lumtur që ata më duan shumë. Dashuria që marrë nga njerëzit është gjëja më e bukur që më ka dhënë sporti që të kenë një shembull frymëzimi,

jo patjetër në fushën e sportit, por me mund dhe sakrificë ia dalin. Shqipëria i ka shumë mundësitë për zhvillimin e sportit.

Çfarë prisni diçka të afërt?

Gega: Unë pres që vitin e ardhshëm të vendos një rekord të ri në maratonën e Vlorës ndoshta në 10 km ose 21 km do ta vendos. Uroj shumë që të vazhdojë kjo traditë këtu në Vlorë.

Cili është mesazhi juaj për të rinjtë?

Gega: Unë kam arritur gjëra të mëdha dhe gjithçka ka ardhur falë punës. Nuk mendoja se do t'i arrija, por me punë arrihen. Shqipëria dhe të rinjtë tanë kanë potencial për të arritur në nivele ndërkombëtare. Duhet të kuptojnë që çdo gjë arrihet me punë dhe me një disiplinë shumë të hekurt, siç e kërkon sporti, por që asgjë nuk është e pamundur. Emocioni që të fal sporti dhe këto të mirat që ai ka janë të panumërta. Duhet një popullatë sa më e shndritshme.

Browni, ylli që shkëlqeu në javën e dytë



Mitrovicë, 26 shtator - Java e dytë në ProCredit Superligë solli tri ndeshje interesante, duke përfshirë derbin në mes të Trepçës dhe Sigal Prishtinës. Mitrovicasit fituan në këtë përballje (77:67), por basketbollisti me indeksin më të lartë ishte Terrell Brown. Ai ndaj kampionit të Kosovës kishte 35 pikë, nëntë kërcime dhe dy asistime, duke pasur indeksin e

ndeshjes 37, apo më të lartin e kësaj xhiroje.

Te "Xehetarët" më i miri ishte Desmond Cambridge Jr me 20 pikë, tetë kërcime dhe tri asistime. Sigal Prishtina regjistroi fitoren e parë këtë edicion, duke fituar ndaj Borës, ku Damiree Burns e përfundoi ndeshjen me dyshifror të dyfishtë, 23 pikë e 13 kërcime, duke shtuar edhe një asistim,

TOP PESËSHJA

Terrell Brown (Golden Eagle Ylli) 35 pikë, 9 kërcime, 2 asistime, 37 indeksi
Damiree Burns (Sigal Prishtina) 23 pikë, 13 kërcime, 1 asistim, 34 indeksi
Jalen Moore (Sigal Prishtina) 15 pikë, 4 kërcime, 11 asistime, 26 indeksi
Ardarryl Clay Jr (Bora) 36 pikë, 2 kërcime, 4 asistime, 23 indeksi
Desmond Cambridge Jr (Trepça) 20 pikë, 8 kërcime, 3 asistime, 20 indeksi

derisa bashkëlojtari i tij, Jalen Moore e mbylli ndeshjen me 15 pikë, katër kërcime dhe 11

asistime. Te Bora më i miri ishte Ardarryl Clay Jr me 36 pikë, dy kërcime dhe katër asistime.

Hashani, trajner i ri i Flamurtarit

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Erdin Hashani është trajneri i ri i skuadrës së Flamurtarit. Njoftimin e ka bërë klubi kuqezi, derisa Hashani e zëvendëson Faruk Stavocin, i cili u lagua ditë me parë nga

klubi për shkak të rezultateve jo të mira. "Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë që kemi arritur marrëveshje me trajnerin Erdin Hashanin. Hashani është trajner i njohur në futbollin kosovar, i cili ka arritur rezultate

shumë të mira me ekipet paraprake dhe me kënaqësi ka pranuar ofertën e klubit. Klubi dhe Hashani kanë nënshkruar kontratë deri në fund të sezonit 2024/25, me mundësi vazhdimi edhe për një sezon tjetër",

thuhet në njoftimin e skuadrës kuqezi nga kryeqyteti. Flamurtari bën pjesë në Ligën e Parë, Grupi B dhe renditet në vendin e fundit në tabelë ku nga gjashtë ndeshje ka regjistruar gjashtë humbje.



Shantazhuan familjen e Schumacherit, kriminelët i pret dënimi shembullor

WUPPERTAL, 26 SHTATOR - Drejtësia gjermane urdhëroi gjykimin e tre të dyshuarve që u përpoqën ta shantazhonin familjen e Michael Schumacherit. Sipas njoftimit të Prokurorisë Publike, i akuzuari ka tentuar të zhvatë 15 milionë euro nga familja e ish-pilotit të Formula 1, duke kërcënuar se do të publikojë në

internet të dhëna të cilat familja nuk ka dashur të publikohen. Bëhet fjalë për pamje të legjendës së Formula 1 para dhe pas aksidentit. Më i madhi nga shantazhuesit, 53-vjeçar, përballet me një dënim nga një deri në pesëmbëdhjetë vjet burg. Djali i tij, i akuzuar për bashkëpunim, përballet me një

dënim më të lehtë (deri në pesë vjet) dhe është i lirë. Ish-pjesëtari i sigurisë së familjes Schumacher, i cili akuzohet për bashkëpunim në tentativë shantazhi dhe shkelje të jetës private, përballet me një dënim "të rëndë" me burg, sipas Prokurorisë Publike të Wuppertalit. Një 52-vjeçar

akuzohet se është anëtar i tretë i grupit që dyshohet se ka kërkuar 15 milionë euro për moszbulimin e imazheve private të ish-pilotit. Duhet mbajtur mend se, në fund të vitit 2013, në resortin francez të sporteve dimërore Meribel, shtatë herë kampioni i F1 pësoi një dëmtim të rëndë në kokë. Ai



kalo i gati gjashtë muaj në koma dhe, që atëherë, është trajtuar në shtëpinë e tij në Zvicër, larg syrit të publikut.

Interesim i jashtëzakonshëm për ndeshjen Bayern - Leverkusen, biletat janë shitur dy muaj më parë

MUNCHEN, 26 SHTATOR - Të shtunën e gjithë vëmendja e mbarë opinionit sportiv do të jetë e mbërthyer në "Allianz Arena", tekta përballen dy skuadrat rivale të dy sezoneve të fundit për titullin kampion, Bayern Munchen dhe Bayer Leverkusen. Nënkampionët e Bayernit kundrejt kampionëve aktualë, "Aspirinat" e Xabi Alonsos, në një 90 minutësh që pritet të jetë spektakolar. Pas katër javëve të para të dyja skuadrat ndahen me vetëm 3 pikë, me ekipin e Vincent Kompany që është treguar perfekt në këtë start kampionati, tekta i ka fituar të katër sfidat, ndërkohë që Leverkuseni numëron 3 fitore dhe 1 humbje atë ndaj Leipzigit. Bayerni kërkon menjëherë të rikthejë titullin në Bavari, pasi sezonin e fundit ishte Leverkuseni që dominoi duke fituar titullin e parë në histori. Skuadra e Bayernit do të kërkojë edhe revanshin e sezonit të fundit edhe sa iu takon sfidave



direkte, ku në Munchen në fazën e parë ndeshja përfundoi në barazim 2-2, ndërsa në ndeshjen e kthimit "Aspirinat" triumfon thellë 3-0, një sfidë që përcaktoi në një farë mënyre edhe sezonin, me kuqezinjët që u kurorëzuan në fund si kampionë. Gjermanja "Kicker" ka publikuar edhe një informacion shumë interesant lidhur me interesimin për këtë ndeshje. Sipas saj, biletat për sfidën

që do të zhvillohet të shtunën në "Allianz Arena" janë shitur të gjitha, më 25 korrik, rreth 2 muaj më parë. Ndërkohë që interesimin ka qenë aq shumë i lartë, tekta numërohen rreth 351 000 kërkesa për të siguruar një biletë. Një gjë është e sigurt: Tifozët që do të shohin nga shkallët e "Allianz Arenës", supersfidën mes Bayernit dhe Leverkuseni duhet ta konsiderojnë veten me shumë fat.

Enrique: Nuk do ta kisha trajnuar PSG-në me Messin, Neymarin dhe Mbappen

PARIS, 26 SHTATOR - Në dokumentarin që "Movistar+" i dedikoi, Luis Enrique bëri një deklaratë që tërheq vëmendjen e të gjithëve. Trajneri spanjoll nuk do ta kishte marrë kurrë përsipër ta drejtonte versionin e vjetër të PSG-së. Para së gjithash, sepse vetë ish-trajneri i Barcelonës nuk do ta kishte imagjinuar kurrë se do të mund të ulej në atë stol para largimit të Messit dhe Neymarit. Ish-trajneri i kombëtares spanjolle midis viteve 2018 dhe 2022 nuk ndihej në harmoni me politikën e transferimeve të klubit transalpin, i cili ishte i fokusuar në rekrutimin e shumë kampionëve. Kjo nuk ishte në rregull për shijet e tij. Në deklaratat e raportuara nga "Marca", Luis Enrique pranoi: "Unë nuk do ta kisha trajnuar PSG-në me Messin, Neymar dhe Mbappe, të tre bashkë në një ekip".



Pas dy sezoneve "të thata" të Ligës së Kampionëve, epoka "MNM" mori fund në verën e vitit 2023. Pasi mbërriti si lojtar i lirë dy vjet më parë, ylli argjentinas nuk donte ta rinovonte kontratën e tij dhe u transferua në ekipin e MLS, Inter Miami. Nga ana tjetër, Neymar i shiti për 90 milionë euro tek Al-Hilali në Arabinë Saudite. Të dy ishin menaxhuar te Barça nga vetë Luis

Enrique, duke fituar Ligën e Kampionëve në vitin 2015. Kështu, pas mbërritjes së tij, spanjollit e gjeti veten vetëm me Mbappen, të cilin arriti ta shijonte deri në sezonin e kaluar, para se të transferohej te Real Madridi. Gjithsesi, zhvillimet me atë trajner shkuan të gjitha në linjën e pajtueshme dhe inovative të PSG-së për të mos e orientuar gjithçka rreth yjeve. Siç kërkoi "Lucho".

SHKURT

Leclerc: Unë jam fajtor për rezultatin e dobët në Singapor

Vendi i pestë në garën e Singaporit nuk është rezultati që Ferrari dhe Charles Leclerc synonte të arrinte në pistën qytetase të Marina Bay. Piloti monogask i është rikthyer garës së fundit duke pranuar se gabimet aty kanë nisur që më herët, gjatë provave zyrtare. "Unë jam fajtor për rezultatin negativ në Singapor. Në atë garë është e qartë se pagova rezultatin e dobët në kualifikuese. Ndaj, fitorja ishte e pamundur pasi u nisa nga vendi i nëntë dhe vetëm duhej të rikuperonim. Gjithsesi, mendoj se bëmë një punë të shkëlqyer", ka thënë Leclerc. "Ne u përpoqëm gjatë garës të bëjmë diçka ndryshe, por ishte e pamundur të shkonim më shumë se vendi i pestë. Ky rezultat është një zhgënjim pasi kishim pretendime më të mëdha në këtë garë, por kjo do të na shërbejë si leksion", u shpreh piloti i "kokëkuqes".

Matthaus: Rodri e meriton 'Topin e Artë'

Legjenda gjermane Lothar Matthaus beson se Vinicius Junior nuk e meriton ta fitojë "Topin e Artë" pavarësisht prej sezonit të tij të jashtëzakonshëm me Real Madridin. Matthaus deklaroi se ndërsa Vinicius Jr ka pasur një vit të mrekullueshëm, ai e sheh atë vetëm si lojtarin e tretë më të mirë në botë. "Të fitojë Vinicius 'Topin e Artë' nuk do të më befasonte. Golashënuesit janë gjithmonë në qendër të vëmendjes, dhe me fitoret në Ligën e Kampionëve dhe La Liga, ai ka fituar vlefshmërinë", ka thënë Matthaus. Megjithatë, gjermani e renditi Vinicius Jr pas të tjerëve në vlerësimin e tij, duke shprehur një pëlqim të fortë për Rodrin. "Për mua, Rodri e meriton 'Topin e Artë' më shumë se Vinicius Jr. Ai ishte truri dhe kapiteni i kombëtares spanjolle që fitoi Euro 2024 dhe, gjithashtu, fitoi titullin e Ligës Premier me Manchester Cityn. Ai ka qenë lojtari i spikatur këtë vit. Bellingham, ashtu si Vinicius, fitoi Ligën e Kampionëve dhe La Ligën. Ai ishte vendimtar për Anglinë, duke e ndihmuar të arrinte në finalen e Evropianit. Renditja ime është Rodri i pari, Bellingham i dyti dhe Vinicius i treti", ka deklaruar Matthaus.

Situatë e pazakontë te Lakersi, LeBron Jamesi godet dhe ofendon të birin bashkëlojtar

LeBron James dhe i biri i tij Bronny janë pjesë e Los Angeles Lakersit, tekta NBA sheh një sezon të ri special, ku për herë të parë në histori babë e bir luajnë në një ekip. Tej zhuvmës për këtë arritje, Bronny dhe LeBron kanë qenë aktorët kryesorë të një përplasjeve në stërvitjen e ekipit nga Los Angeles. Në një moment gjatë stërvitjes, ndodhi që djali i tij të luante në mbrojtje ndaj LeBronit. Sipas raportimeve, në një moment Bronny pati fatin e keq të prekte apo godiste në dorë babanë e tij, i cili sulmonte vijën e gjuajtjeve të lira me topin në dorë. Aksioni përfundoi me LeBronin që u shkëput nga Bronny në kosh dhe shënoi, më pas u kthye drejt tij dhe filloi me fjalë të ashpra, ofendime dhe provokime. Djali i koshshënuesit më të mirë në historinë e NBA-s (40,474 pikë) u zgjodh nga lakersat si zgjedhja e 55-të në draftin e këtij viti. Bronny ka lindur në vitin 2004, kur babai i tij ishte një debutues 19-vjeçar me Cleveland Cavaliersin.

Reali i hapur për vazhdimin e bashkëpunimit me Ancelottin

Carlo Ancelotti dëshiron ta rinovojë kontratën me Real Madridin. Marrëveshja aktuale skadon në vitin 2026, por ai ende nuk ka përcaktuar një datë përfundimi për karrierën e tij menaxheriale. Sipas gazetës "AS",

Ancelotti mbetet i hapur për të vazhduar me Real Madridin përtej vitit 2026. Presidenti i klubit, Florentino Perez, i cili rinovoi kontratën e Ancelottit vitin e kaluar pa prituri fundin e sezonit, është i kënaqur

me punën e menaxherit veteran, tekta vlerëson menaxhimin taktik dhe ndërpersonal të italianit të ekipit. Raporti thekson se Perez i sheh Ancelottin si menaxherin ideal për ekipin nga Bernabeu, veçanërisht

duke vënë në dukje stafin e tij efikas të stërvitjes, duke përfshirë djalin e tij, Davide, dhe trajnerin e fitnesit, Pintus. Kjo strukturë solide mbështetëse është një ndryshim nga menaxherët e mëparshëm si Manuel Pellegrini dhe Rafa

Benitez, të cilët u përballën me më shumë shqyrtim. Ancelotti aktualisht gëzon mbështetje të fortë si nga tifozët, po ashtu edhe nga hierarkia e klubit. Megjithatë, ai e kupton se në futboll suksesi në fund matet me rezultatet në fushë.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “DEEN CAFFE” SH.P.K. me seli në Lipjan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812123066 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “DEEN CAFFE” D.O.O. Lipjan, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812123066 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “DEEN CAFFE” L.L.C. with headquarters Lipjan, has come to the decision to quit its business: 812123066 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Institucioni Parashkollor ALPHA KIDS” SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812053479 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Institucioni Parashkollor ALPHA KIDS” D.O.O. Fushë Kosovë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812053479 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Institucioni Parashkollor ALPHA KIDS” L.L.C. with headquarters Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: 812053479 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Thirrje për aplikim

IRON CONSULTING L.L.C., NUI 810819691, po kërkon ofertues / kontraktor / kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë ofertë/propozim për:

"Furnizim me sistem kundër breshërit për sipërfaqe 1.70ha sipas specifikacionit teknik dhe arka te plastikes për deponim te mollës"

Nr. Prokurimit 01/24 IRON CONSULTING.

Emri: IRON CONSULTING L.L.C.

Të interesuarit për aplikim dosjen me specifika mund ta kërkojnë përmes e-mailit:

info@iron-consulting.eu

Adresa: Rr. Hajdar Dushi, Hyrja 1, Nr. 11, Prishtinë

Tel: +383 45 550 400;

Ofertat duhen dorëzuar më së largu 15 ditë nga publikimi i shpalljes, ora 14:00, në Adresë:

Rr. Hajdar Dushi, Hyrja 1, Nr. 11, Prishtinë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Divia” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër Unik Identifikues: 810872897.

- Nizafet Haraqija Llapaqi Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Hyrçe Mamusha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë

- Ylber Morina shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.

- Alberina Gashi shpall te pavlefshme diplomën Q.K “11 Marsi “ Prizren.

- Fiona Gashi shpall te pavlefshme 1 dëftesë dhe diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.

- Fiona Gashi shpall te pavlefshme 2 dëftesa sh.m. “Skender Laurasi” Suharek.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

| | |
|-----------------------------------|----------------------------------------------------------|
| Titulli i vendit të punës: | Zyrtar/e i ri për Llogari të pagueshme dhe Pagesa |
| Grada e pozitës: | 7 |
| Kohëzgjatja e punësimit: | me afat të pacaktuar |
| Departamenti: | i Financave |
| Divizioni | i Kontabilitetit dhe mbështetjes |
| Raporton tek: | Udhëheqësi i Divizioni të Kontabilitetit dhe Mbështetjes |

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Përgatit formularët dhe proceson pagesat për të gjitha llogarit e pagueshme (vendore dhe ndërkombëtare) sipas dokumentacionit përkatës mbi dokumentet e pagueshme, duke përfshirë dhe ato për në para të gatshme dhe pagesa të vogla;
- Përgatit dhe plotëson formularët e tërheqjes në para të gatshme;
- Ndihmon në përgatitjen e formularëve të pagesave vendore dhe ndërkombëtare;
- Bazuar në dokumentacionin përkatës regjistron pagesat për të gjitha llogarit e pagueshme në sistemin bazë kontabël;
- Mban evidencën/listën e të gjithë dokumentacionit të ndërlidhur me llogarit e pagueshme, përfshirë edhe pagesat e vogla dhe ato me para të gatshme, si dhe përkujdeset që ato të janë në përputhje me politikën, rregullat dhe procedurat e aplikueshme;
- Zëvendëson zyrtaren e kontabilitetit në mungesë të tij/saj; dhe
- Kryen detyra tjera sipas kërkesës së vijës raportuese.

Njohurit e kërkuara:

- Diploma e Universitetit në Ekonomi/ks, Financa, Kontabilitet, Menaxhim Afarist apo Matematikë Financiare dhe të ngjajshme;
- Preferohet të këtë certifikim në kontabilitet (në shoqatat profesionale vendore dhe/ose ndërkombëtare);
- Njohuri të mira të punëve bankare paraqet përparësi;
- Njohuri të mira në Excel dhe Word, si dhe preferohet të ketë përvojë pune me aplikacione (bankare) të raportimit financiar dhe kontabilitetit.

Përvoja e kërkuar:

Preferohet 1 (një) vit përvojë pune në bankë ose institucione jo bankare në financa, kontabilitet financiar ose kontabilitetin e shpenzimeve.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **11 tetor 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

| | |
|--------------------------------|-----------------------------------------------|
| Naziv radnog mesta: | Mladi službenik za obaveze i plaćanja |
| Stepen pozicije: | 7 |
| Trajanje radnog odnosa: | na neodređeno vreme |
| Odeljenje: | za finansije |
| Odsek | za računovodstvo i podršku |
| Izveštava: | rukovodiocu Odseka za računovodstvo i podršku |

Pregled dužnosti i odgovornosti:

- Priprema obrasce i obrađuje plaćanja za sve obaveze (domaće i međunarodne) prema relevantnoj dokumentaciji o ispravama za plaćanje, uključujući gotovinu i sitna plaćanja;
- Priprema i popunjavanje obrasce za podizanje gotovine;
- Pomaže u pripremi domaćih i međunarodnih platnih obrazaca;
- Na osnovu relevantne dokumentacije evidentira uplate za sve obaveze prema osnovnom računovodstvenom sistemu;
- Održava evidenciju/liste za svu dokumentaciju u vezi sa obavezama, uključujući male uplate i gotovinska plaćanja, i osigurava da su u skladu sa važećim politikama, pravilima i procedurama;
- Zamenjuje službenika računovodstva u njegovom/njenom odsustvu; i
- Obavlja i druge poslove prema zahtevu linije za izveštavanje.

Potrebna znanja:

- Univerzitetska diploma iz ekonomije, finansija, računovodstva, poslovnog menadžmenta ili finansijske matematike i slično;
- Poželjan je sertifikat iz računovodstva (u domaćim i/ili međunarodnim profesionalnim udruženjima);
- Dobro poznavanje bankarstva je prednost;
- Poželjno je dobro poznavanje Excela i Worda, te iskustvo u radu sa (bankarskim) aplikacijama za finansijsko izveštavanje i računovodstvo.

Potrebno iskustvo:

Poželjno je 1 (jedna) godina radnog iskustva u banci ili nebankarskoj instituciji u oblasti finansija, finansijskog računovodstva ili računovodstva troškova.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeću dokumentaciju:

- Službeni obrazac CBK-a za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak prijave:

- Poslednji rok za podnošenje prijava je **11 oktobar 2024**.
- Prijava se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali načini za podnošenje prijave neće se razmatrati.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti putem službene veb stranice: www.bqk-kos.org

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

